

VENDIM
Nr. 317, datë 17.5.2012

**PËR LEJIMIN E EKSPOZIMIT TË DISA DOKUMENTEVE ORIGJINALE DHE
OBJEKTEVE TË RRALLA ME VLERA HISTORIKE, IKONA DHE KODIKË, NË
STRASBURG, NË KUADËR TË MARRJES SË KRYESISË SË KOMITETIT TË
MINISTRAVE TË KËSHILLIT TË EUROPËS, NGA DATA 23-25 MAJ 2012**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 3 të nenit 19 të ligjit nr. 9048, datë 7.4.2003 “Për trashëgiminë kulturore”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Lejimin e ekspozimit jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë të disa dokumenteve origjinale dhe objekteve të rralla me vlera historike, ikona dhe kodikë, në Strasburg, në kuadër të marrjes së kryesisë së Komitetit të Ministrave të Këshillit të Europës, nga data 23-25 maj 2012, sipas lidhjes nr. 1 që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

2. Ekspozimi jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë të bëhet në përputhje me udhëzimin nr. 2, datë 18.3.2004 të Këshillit të Ministrave “Për lëvizjen e objekteve të trashëgimisë kulturore të luajtshme, me vlera të veçanta kombëtare dhe unike, për restaurimin, studimin dhe ekspozimin jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë”.

3. Ngarkohen Ministria e Punëve të Jashtme të kryejë shoqërimin dhe kthimin e ikonave e të kodikëve në vendin e origjinës, pas mbarimit të veprimtarisë dhe Qendra e Inventarizimit të Pasurive Kulturore të kryejë regjistrimin e lëvizjes së objekteve.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha